



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 21, datë 28.02.2023

**PËR
MIRATIMIN E KËRKESËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË SË BROKERIT NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Z. Genci Goga është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me Vendimin e Bordit nr. 238, datë 17.01.2020 “Për miratimin e ushtrimit të veprimtarisë së brokerit në sigurime, në klasat e jojetës” dhe mban Licencën nr. 88, datë 19.12.2019.

Me shkresën nr. 430 prot., datë 03.02.2023, z. Genci Goga për arsye të mos ushtrimit të aktivitetit, parashton se tërhiqet vullnetarisht nga ushtrimi i veprimtarisë si broker në sigurime dhe kërkon miratimin e kërkesës për heqjen e licencës si: “Broker në Sigurime – Person Fizik”.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe kërkesës së vetë subjektit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e kërkesës së z. Genci Goga për heqjen e licencës si: “Broker në Sigurime – Person Fizik”, për ushtrimin e veprimtarisë së brokerit në sigurime.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE